

MIRATOHET
MINISTRI

GENC BULLI



RREGULLORE

PER

PROCEDURAT E MIRATIMIT TE MARREVESHJEVE HIDROKARBURE DHE LICENCE MARREVESHJEVE SI DHE AFATET PERKATESE

1. Kjo rregullore ka per objekt percaktimin e procedurave te miratimit te marreveshjeve hidrokarbure, licence marrveshjeve, si dhe afatet perkatese per miratimin e tyre.
2. Procedura per pergatitjen dhe miratimin e nje Marreveshje Hidrokarbure, nga AKBN dhe Albpetrol, sipas zonave qe kane ne administrim, si dhe afatet kohore te miratimit te tyre, jane si me poshte:
 - a. Subjekti i interesuar paraqet prane AKBN apo Albpetrol-it nje aplikim per te hyre ne Marreveshje Hidrokarbure, keto te fundit duhet t'i paraqesin Ministrise dokumentacionin e nevojshem dhe kerkesen per miratimin e fillimit te negociemeve.

Afatet:

 - AKBN apo Albpetrol do t'i paraqese Ministrise dokumentacionin e nevojshem dhe kerkesen per miratimin e fillimit te negociemeve brenda 15 diteve nga marrja e aplikimit.
 - Ministria do te jape aprovoje ose jo per fillimin e negociatave, brenda 10 diteve nga marrja e kerkeses nga AKBN apo Albpetrol.
 - b. Ne rast miratimi, perfaqesuesit AKBN apo Albpetrol fillojne negociimin me subjektin e interesuar per Termat dhe Kushtet Kryesore te Marreveshjes Hidrokarbure, ne baze te aplikimit te paraqitur nga subjekti i interesuar. Pasi bien dakort , dokumenti nenshkruhet- nga te dy palet dhe i percillet Ministrise per miratim.

Afatet:

 - AKBN apo Albpetrol do t'i percjelle Ministrise per miratim Termat dhe Kushtet Kryesore te Marreveshjes brenda 10 diteve nga data e nenshkrimit.

- Ministria do të japë miratimin apo refuzimin e saj për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes brenda 10 ditëve nga marrja e dokumentit të nënshkruar të Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjes.
- c. Në rast miratimi të Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure, AKBN apo Albpetroli, fillojnë procesin e negociimit. Procesi përfundon kur drafti përfundimtar firmoset në çdo faqe nga përfaqësuesit e AKBN apo Albpetroli dhe subjektit të interesuar. Drafti i përfunduar përkethehet në shqip dhe i përcillet Ministrisë për miratim. Në rast se AKBN apo Albpetroli gjykojnë të nevojshme, kryejnë opionencë, drafti rishikohet dhe i përcillet Ministrit për miratim.

Afatet:

- AKBN apo Albpetroli do të fillojnë negociimet brenda 30 ditëve nga marrja e miratimit për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure.
 - AKBN apo Albpetroli do t'i përcjellë Ministrisë për miratim draftin përfundimtar të Marrëveshjes Hidrokarbure brenda 15 ditëve nga data e firmosjes së tij në çdo faqe nga palet.
 - Kur drafti çohet për opionencë, atëherë rinegociimi dhe rishikimi i draftit bëhen brenda 20 ditëve nga data e marrjes së opionencës.
- d. Drafti i firmosur i Marrëveshjes Hidrokarbure, mund të dërgohet për opionencë nga Ministria, nëse e gjykon të nevojshme. Ministria e dërgon draftin për mendim në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë. Në rast vërejtjesh nga opionencë e kryer ose Ministrinë e siperpërmendura dhe kur ato gjykojnë si të drejta, drafti rinegocionet. Pas kryerjes së rinegociimit, Albpetroli e përcjell draftin e rinegocionuar për miratim, ndërsa AKBN për miratim dhe nënshkrim, tek Ministri.

Afatet:

- Kur drafti çohet për opionencë, atëherë rinegociimi dhe rishikimi i draftit bëhet brenda 20 ditëve nga data e marrjes së opionencës.
 - Kur drafti çohet për mendim në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë, atëherë rinegociimi dhe rishikimi i draftit bëhet brenda 20 ditëve nga data e marrjes së mendimit nga Ministrinë e mesipërme.
 - Drafti i rinegocionuar dërgohet në Ministri brenda 10 ditëve.
 - Ministri është gati të nënshkruajë Marrëveshjen Hidrokarbure për zonat që administrojnë AKBN, brenda 10 ditësh.
 - Ministri jep miratimin për nënshkrimin e Marrëveshjes Hidrokarbure për zonat që administrojnë Albpetroli, brenda 10 ditëve. Albpetroli duhet të jetë gati për nënshkrimin e Marrëveshjes Hidrokarbure brenda 10 ditëve nga ky miratim.
- e. Me nënshkrimin e Marrëveshjes Hidrokarbure, ajo dërgohet për miratim përfundimtar në Këshillin e Ministrave.

3. Procedura per pergatitjen dhe miratimin e nje Licence Marreveshje, si dhe afatet kohore te miratimit te tyre, jane si me poshte:

a. Albpetrol paraqet prane AKBN kerkesen per tu pajisur me Licence Marreveshje nga Ministri, pas miratimit te Termave dhe Kushteve Kryesore te Marreveshjes Hidrokarbure nga Ministria.

Afatet:

- Kerkesa paraqitet brenda 10 diteve nga nenshkrimi i dokumentit te Termave dhe Kushteve Kryesore te Marreveshjes Hidrokarbure.

b. AKBN pergatit dhe i dergon Albpetrol-it draftin e Licence Marreveshjes. Drafti i Licence Marreveshjes diskutohet mes Albpetrol-it dhe AKBN dhe pergatitet drafti perfundimtar qe firmoset ne cdo faqe. Drafti perfundimtar i paraqitet Ministrise per miratim dhe nenshkrim.

Afatet:

- AKBN brenda 30 ditesh pergatit dhe i paraqet Albpetrol-it draftin e propozuar te Licence Marreveshjes.
- Diskutimet per draftin perfundimtar kryhen brenda 50 ditesh.
- Drafti perfundimtar i paraqitet Ministrise per miratim dhe nenshkrim brenda 10 diteve.
- Ministri brenda 10 diteve nenshkruan apo kerkon berjen e ndryshimeve.
- Ne rast se Ministri kerkon ndryshimin e draftit, ato kryhen brenda 30 diteve dhe drafti i rishikuar i Licence Marreveshjes riparaqitet per nenshkrim.
- Licence Marreveshja nenshkruhet nga Ministri dhe Albpetroli brenda 10 ditesh, pasi eshte dhene miratimi per Marreveshjen Hidrokarbure.